

VENDIM
Nr. 383, datë 6.6.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN,
ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË DET NË SHQIPËRI,
BLLOQET 2, 3 DHE 4 TË ADRIATIKUT, NDËRMJET “ALBPETROL”, SHA-SË, DHE
SHOQËRISË “EMANUELLE ADRIATIC ENERGY LIMITED”**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në det në Shqipëri, bllloqet 2, 3 dhe 4 të Adriatikut, ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së dhe shoqërisë “Emanuelle Adriatic Energy Limited”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha